


Indeksi i Çmimeve të Prodhimit

Tremujori I, 2025

Tiranë, më 05 Qershor 2025: Në tremujorin e parë të vitit 2025, Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (IÇP) arriti 129,7, kundrejt vitit 2021 si periudhë bazë. Indeksi i Çmimeve të Prodhimit shënoi rritje vjetore me 0,4 % dhe rritje tremujore 0,3 %.

Fig. 1 Indeksi i Çmimeve të Prodhimit



Rritja më e lartë vjetore u shënuar në seksionin "Energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar " me 1,0 %, e ndjekur nga seksionet "Industri nxjerrëse" 0,7 % dhe "Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve" me 0,5 %. "Industri përpunuese" shënoi një rritje me 0,03 %. Brenda këtij seksioni, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në aktivitetin "Prodhimi i mobiljeve" me 2,1 %, ndërsa ulja më e madhe e çmimeve vërehet në aktivitetin "Metalurgji" me 2,4 %.

IÇP për tregun vendas; Shënoi një rritje vjetore prej 0,7 %. Rritja vjetore më e madhe u vu re në seksionin "Industri përpunuese" me 1,1 % dhe në sektorin "Energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar" me 0,8 %, ndërsa "Industri nxjerrëse" shënoi një rënie prej 1,8 %.

IÇP për eksport; Shënoi rritje vjetore prej 0,3 %. Rritja më e madhe vjetore u shënuar nga seksioni "Industri nxjerrëse" me 2,8 %. Ndërkohë, "Industri përpunuese" shënoi një rënie prej 0,2 %.

Ndryshimet tremujore

Në krahasim me tremujorin IV-2024, IÇP shënoi një rritje me 0,3 %. Rritja më e madhe vërehet në seksionin “Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajri i kondicionuar” me 0,4 %, pasuar nga seksioni “Industri përpunuese” me 0,2 %.

IÇP për tregun vendas, shënoi një rritje tremujore prej 0,2 %, rritje më të lartë shënoi seksioni “Industri përpunuese” me 0,3 %. Nga ana tjetër, seksioni “Industri nxjerrëse” shënoi ulje me 0,7 %.

IÇP për eksport, shënoi një rritje prej 0,2 %, me rritjen më të madhe në seksionin “Industri nxjerrëse” me 0,8 %. Nga ana tjetër, seksioni “Industri përpunuese” ka shënuar ulje me 0,1 %.

Për më shumë informacion dhe për të parë tabelat e detajuara, vizitoni bazën e të dhënave në faqen zyrtare të INSTAT: [Indeksi i Çmimeve të Prodhimit](#)

Metodologjia

INSTAT llogarit dhe publikon:

- Indeksin e Çmimeve të Prodhimit Gjithsej
- Indeksin e Çmimeve të Prodhimit të produkteve për tregun vendas
- Indeksin e Çmimeve të Prodhimit të produkteve për eksport

Fusha e mbulimit:

- Seksioni B - Industri nxjerrëse
- Seksioni C – Industri përpunuese
- Seksioni D - Furnizimi me energji elektrike, gaz e avull dhe me ajër të kondicionuar
- Seksioni E - Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve

Llogaritja e indeksit

Indekset llogariten për çdo produkt të klasifikuar sipas Nomenklaturës së Produkteve (NP 2008) në nivel 6-shifror dhe publikohen sipas degëve të ekonomisë në nivel 2-shifror. Rinovimi i kampionit të ndërmarrjeve dhe shportës së produkteve realizohet çdo vit duke përdorur rezultatet e Anketës Strukturore pranë Ndërmarrjeve Ekonomike jo Bujqësore. Përcaktimi i peshave të produkteve me destinacion tregun vendas mbështetet në rezultatet e po kësaj ankete, ndërsa peshat e produkteve me destinacion eksportin mbështeten në të dhënat statistikore të Tregtisë së Jashtme.

Duke filluar nga tremujori i parë 2024 e në vazhdim Indeksi i Çmimeve të Prodhimit ka si periudhë referuese vitin 2021 = 100. Metoda e llogaritjes së indeksit është metoda zinxhir (Laspeyres - chain index) sipas së cilës, çmimi i produktit në periudhën korente (y) krahasohet me çmimin e muajit Dhjetor të vitit të mëparshëm (y – 1);

$$I_{korrent}^{y,m} = \frac{100}{\frac{1}{12} \sum^{Dec} I_{Y-1,Dec}^{Y,M}} + \prod_{Y=viti\ bazë}^{y-1} I_{Y-1,Dec}^{Y,M} * I_{y-1,Dec}^{y,m}$$

- Pjesa e parë e formulës tregon ndryshimin e çmimeve të muajit Dhjetor të vitit të mëparshëm krahasuar me mesataren e çmimeve në vitin bazë.
- Pjesa e dytë e formulës tregon lëvizjen zinxhir të indeksit të çmimeve nga muaji Dhjetor të vitit të mëparshëm deri në periudhën y-1.
- Pjesa e tretë e formulës tregon ndryshimin e çmimeve nga muaji Dhjetor y-1 në muajin m të vitit y.

Matësit e Indeksit

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e çmimit midis tremujorit korent dhe të njëjtit tremujor të vitit të kaluar. Ky

ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve vjetore në nivelet e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të çdo tremujori.

Ndryshimi tremujor krahason nivelet e çmimit të dy tremujorëve të fundit.